



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 1612 Prot.

Shkodër, më 28.04. 2025

V E N D I M

Nr. 137, datë 28.04. 2025

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa d; Statutin e USH-së, neni 17, pika 6, germa r, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 28. 04. 2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren "Për organizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi u përcillet të gjitha njësive kryesore dhe njësivë bazë të Universitetit të Shkodrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin GJURAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

***“Për organizimin e programeve të studimit të
ciklit të tretë të Doktoratës në Universitetin e
Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

Përmbajtja

Kreu I- Dispozita të përgjithshme.....	2
Neni 1. Baza ligjore	2
Neni 2. Objekti dhe qëllimi.....	2
Neni 3. Parimet.....	3
Neni 4. Hapja e programit të studimit të Doktoratës.....	4
Kreu II - Organizimi dhe drejtimi i Doktoratës.....	4
Neni 5. Struktura.....	4
Neni 6. Organet drejtuese.....	4
Neni 7. Komisioni për Dhënien e gradës shkencore “Doktor” (KD).....	4
Neni 8. Njësia bazë.....	5
Neni 9. Autoritetet drejtuese.....	5
Neni 10. Kryetari i KD-së.....	5
Neni 11. Koordinator i Doktoratës.....	5
Neni 12. Personeli akademik.....	6
Kreu III- Organizimi i programeve të studimit të Doktoratës.....	7
Neni 13. Afati i studimeve të Doktoratës.....	7
Neni 14. Programet e përbashkëta të Doktoratës.....	7
Kreu IV-Pranimi i studentëve.....	7
Neni 15. Pranimi i studentëve.....	7
Neni 16. Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve.....	8
Neni 17. Afatet e pranimit në progarmin e studimit Doktoratë.....	9
Neni 18. Plotësimi dhe njohja e krediteve.....	10
Neni 19. Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të Doktoratës.....	10
Kreu V-Diplomimi.....	10
Neni 20. Procedura e diplomimit.....	10
Neni 21. Rregullat për paraqitjen e disertacionit.....	11
Neni 22. Etika e punës kërkimore.....	11
Neni 23. Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e Doktoratës.....	12
Neni 24. Mbrojtja e Doktoratës.....	13
Neni 25. Anulimi i gradës shkencore “Doktor”.....	14
Kreu VI-Studentët.....	14
Neni 26.Të drejtat dhe detyrimet e studentit të Doktoratës.....	14
Kreu VII-Financimi.....	15
Neni 27. Burimi i financimit.....	15
Neni 28. Tarifa e shkollimit dhe tarifa e regjistrimit.....	15
Kreu VIII-Marrëdhëniet me partnerët.....	15
Neni 29. Marrëdhëniet me partnerët.....	15
Kreu IX-Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit të Doktoratës.....	16
Neni 30. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit të Doktoratës.....	16
Kreu X-Dispozita të fundit.....	16
Neni 31. Dispozita kalimtare.....	16
Neni 32.....	16

Kreu I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Baza ligjore

Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar; VKM nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar; VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; Udhëzimin e MASR nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; VKM nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë"; Statutin e USH-së, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR nr. 16, datë 08.07.2019 "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave"; Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor"; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MASR nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", i ndryshuar.

Neni 2 Objekti dhe qëllimi

- 2.1. Rregullorja përcakton strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të saj; të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik, të studentëve e të bashkëpunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për kërkimin, për vlerësimin, për diplomimin dhe çdo aspekt tjetër të organizimit akademik dhe administrativ në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- 2.2. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregulla të përgjithshme mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë (departament ose qendër kërkimore) të Universitetit të Shkodrës.
- 2.3. Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor".
- 2.4. Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor në një fushë/ nënfushë të caktuar, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe reintegrimit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.
- 2.5. Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese,

të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit), të nevojshme për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe lidhen me projekte kërkimore të njësive bazë.

2.6. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat/nënfushat e përcaktuara nga njësitë bazë. Njësitë bazë/ qendrat kërkimore shpallin fushat/nënfushat kryesore sipas objektivave të tyre ose fusha të përbashkëta ndërmjet tyre me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.

Neni 3

Parimet

3.1. Doktorata e zhvillon veprimtarinë në bazë të parimeve të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë, të efektshmërisë dhe të vetëfinancimit.

3.1.1. *Liria akademike* nënkupton vetëveprimin kërkimor-shkencor në përputhje me standardet akademike bashkëkohore, mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimtarisë akademike. Ajo vështrohet si parakusht për mendimin kritik e krijues, si dhe për avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.

3.1.2. *Autonomia institucionale* i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë administrative për përmbushjen e misionit të doktoratës.

3.1.3. Parimi i *cilësisë* nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës, si në aspektin e kërkesave, ashtu edhe të pritshmërisë, të cilat duhet të plotësohen për të rritur cilësinë e synuar. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së doktoratës.

3.1.4. *Efektshmëria* nënkupton funksionimin e doktoratës në mënyrë të tillë që çon në realizimin e qëllimeve dhe të objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një strategjie të parashikuar dhe që programi të arrijë rezultate të mira me kosto të pranueshme për shoqërinë, të përdorë burimet njerëzore e materiale në mënyrë optimale.

3.1.5. Programi i doktoratës siguron burime të qëndrueshme financimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me politikat e vetëfinancimit të institucioneve të arsimit të lartë.

3.2. Njësitë bazë të Fakultetit/Institutit/Qendrës janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës. Kriteret e pranimi të studentëve në programin e studimit të doktoratës përcaktohen nga njësitë bazë.

3.3. Nëse programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, përcaktohen në përputhje me Rregulloren e doktoratës Ndërdisiplinore.

3.4. Komisioni për Dhënie të gradës shkencore “Doktor” është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e doktorantit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për Dhënie të gradës shkencore “Doktor”.

3.5. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.

Neni 4

Hapja e programit të studimit të doktoratës

4. Njësia bazë nëpërmjet njësisë kryesore, i paraqet Senatit të USH-së, propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës ose për riorganizimin e një programi ekzistues, propozim i cili formulohet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Kreu II

Organizimi dhe drejtimi i doktoratës

Neni 5

Struktura

5. Doktorata ka këtë strukturë organizative:

- a. Organet drejtuese,
- b. Autoriteti drejtues.

Neni 6

Organet drejtuese

6. Organet drejtuese janë:

- a. Komisioni për Dhënien e gradës shkencore "Doktor" (në vijim *Komisioni i doktoratës - KD*),
- b. Njësia bazë.

Neni 7

Komisioni për Dhënien e gradës shkencore "Doktor" (KD)

7.1. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" është Komision i përhershëm që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të Dhënies së gradës shkencore "Doktor".

7.2. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e asamblesë së personelit akademik, të njësisë kryesore që ofron programin e studimit. Anëtarët duhet të jenë të kategorisë "Profesor". Ata kanë mandat 2 - vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

7.3. "Detyrat e KD-së" janë :

- Me propozim të njësisë bazë, KD shqyrton Draft *Rregulloren përkatëse* të doktoratës dhe ia kalon Dekanatit për miratim.
- Zgjedh me shumicë votash Kryetarin e KD-së.
- KD me propozim të koordinatorit:
 - a. miraton programin e kërkimeve të doktoratës dhe projektet e saj;
 - b. miraton vendosjen e lidhjeve të bashkëpunimit me shkollat analoge të vendit e të huaja apo anëtarësimin në shoqata kombëtare e ndërkombëtare, që kanë si objekt çështje të arsimit të lartë apo të kërkimit shkencor;
 - c. analizon çdo vit raportin e veprimtarisë së doktoratës.

7.4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në

këtë rregullore, ngre jurinë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.

7.5. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me Dhënien e gradës Shkencore "Doktor", pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të jurisë.

Neni 8

Njësia bazë

8.1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

8.2. Njësia bazë përcakton dhe miraton fushat/nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës.

8.3. Njësia bazë përcakton kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve doktorantë, shqyrton dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e tij të doktoratës.

8.4. Njësia bazë miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.

8.5. Njësia bazë ka përgjegjësi t'ju sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.

8.6. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.

8.7. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.

8.8. Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar *Koordinatorit të doktoratës*, ku argumentohen arsyet e ndryshimit të temës. Raporti nënshkruhet prej doktorantit dhe udhëheqësit. Komisioni i Dhënies së gradës *Doktor* vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës.

Neni 9

Autoritetet drejtuese

9. Autoritete drejtuese janë:

- Kryetari i Komisionit të dhënies së gradës "Doktor" (KD),
- Koordinatori i doktoratës.

Neni 10

Kryetari i KD-së

10.1. Kryetari i KD-së zgjidhet me shumicë votash nga të gjithë anëtarët e KD-së për një periudhë prej 2 vjetësh.

10.2. Ai drejton KD-në dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për funksionimin e KD-së.

10.3. Ai bashkëpunon me dekanin e fakultetit dhe koordinatorin për çështje që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e doktoratës.

Neni 11

Koordinatori i Doktoratës

11.1 Programi i studimit të doktoratës në nivel të njësisë bazë ndiqet/drejtohet nga koordinatori i programit të studimit të doktoratës, që zgjidhet ndërmjet anëtarëve të cilët kanë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar”, i cili ka përgjegjësi:

- a) të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në studim;
- b) të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin shkencor, sipas rregullave për caktimin e udhëheqësit shkencor të studimeve të doktoratës;
- c) të kujdeset se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës/nënfushës së kërkimit shkencor, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij;
- ç) të interesohet për t'u siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme;
- d) të marrë masa që kandidatët të plotësojnë të gjitha kriteret dhe standardet për realizimin e punës për hartimin e temës dhe kërkimin shkencor;
- dh) t'u bëjë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj., që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.

11.2. Përveç detyrave të parashikuara si më lart, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës, mund të përcaktojnë edhe detyra të tjera shtesë për koordinatorin e programit, që garantojnë funksionimin e këtij programi studimi.

Neni 12

Personeli akademik

12.1. Personeli akademik përbëhet nga profesorati që zhvillon aktivitetin e tij në doktoratë.

12.2. Personeli akademik, në rolin e udhëheqësit shkencor të studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si dhe për zhvillimin e monitorimin e përparimit të punës së tij kërkimore.

12.3. Në doktoratë pranohen udhëheqës shkencorë të kategorisë “Profesor”. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të BE-së, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë edhe me gradën shkencore “Doktor”.

12.4. Pranimi i udhëheqësve bëhet sipas kriterëve të miratuara nga KD.

12.5. Udhëheqësit shkencorë të huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.

12.6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor janë:

- a. të përmbushë përgjegjësitë për udhëheqjen e tezës;
- b. të ketë në dispozicion informacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave të tij;
- c. të përdorë mjediset dhe pajisjet e doktoratës për veprimtari në dobi të saj;
- ç. të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së doktoratës;
- d. të marrë pjesë në komisione dhe veprimtari të ndryshme të doktoratës;
- dh. të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë studentit arritjen e standardeve të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit të projektit

- kërkimor-shkencor dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit;
- e. në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët, duke siguruar që ato të mbajnë kontakte të rregullta dhe të bashkëpunojnë në mbështetje të studentit;
 - ë. të realizojë periodikisht takime me studentin, duke vlerësuar rregullisht progresin e tij;
 - f. të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është në përputhje me standardet e kërkuara dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse;
 - g. të vetëdijësojë studentin për rrezikun e fallsifikimeve dhe të plagjiaturës;
 - gj. të bashkëveprojë në mënyrë profesionale dhe etike me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët e doktoratës;
 - h. të zbatojë Rregulloren e doktoratës dhe atë të fakultetit përkatës;
 - i. ta nxisë dhe ta mbështesë studentin në përgatitjen e punimeve pjesore të tij, që do të prezantohen në njësinë bazë, në aktivitetin shkencor "*Ditët e doktorantit*", si dhe në botimet apo aktivitetet e tjera shkencore brenda e jashtë vendit, në përputhje të detyrimeve të përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe kjo *Rregullore*;
 - j. të sigurojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e njësisë bazë, kur janë bërë paraqitjet e radhës (tri të tilla) apo kur punimi është rikthyer për riparaqitje.

Kreu III

Organizimi i programeve të studimit të doktoratës

Neni 13

Afati i studimeve të doktoratës

13.1. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.

13.2. Në raste përjashtimore, me kërkesë të doktorantit, Komisioni mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen ose për pezullimin e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total. Për vitet shtesë, tarifa shtesë vendoset me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

Neni 14

Programet e përbashkëta të doktoratës

14. USH mund të organizojë programe të përbashkëta studimi të doktoratës me një ose më shumë universitete apo qendra të tjera kërkimore-shkencore, në bazë marrëveshjes, duke pasur parasysh si më poshtë:

- a. Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse;
- b. Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet, për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
- c. Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet teza e doktoratës apo pjesë të saj, përcaktuar në marrëveshjen midis dy universiteteve;

- c. Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me miratim të drejtuesve të secilit universitet;
- d. Secili universitet i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi gradën “Doktor”, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktrate në bashkëpunim me universitetin.....”

Kreu IV

Pranimi i studentëve

Neni 15

Pranimi i studentëve

- 15.1.** Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “*Master i shkencave*” ose “*Master i arteve*” (ose ekuivalentet e tyre sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi) dhe plotësojnë kriteret e pranimi, të përcaktuara nga USH.
- 15.2.** Kriteret e pranimi në doktoratë përcaktohen nga njësia bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Këto kritere, pasi miratohen nga Senati, bëhen publike nga USH dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- 15.3.** Lista e studentëve fitues dërgohet në QSHA, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80 / 2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”.

Neni 16

Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve

- 16.1.** Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:
- a) të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të paktën një diplomë të ciklit të dytë “*Master i shkencave*”, “*Master i arteve*”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm me njërin prej tyre, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
 - b) të ketë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, sipas përcaktimeve të njësive bazë;
 - c) të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, lidhur me përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë;
 - d) të ketë dy rekomandime nga personel akademik, që kanë titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit.

Përveç kriterëve të parashikuara në këtë pikë, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë edhe kritere të tjera shtesë, që mund të kenë lidhje me aftësitë kërkimore-shkencore të aplikantëve.

- 16.2.** Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet në njësinë bazë dhe përmban dokumentet e mëposhtme:

- a) Curriculum Vitae;
- b) kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", diplomë specializimi afatgjatë ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave, ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- c) fotokopjen e kartës së identitetit/pasaportës;
- ç) dy rekomandime nga personel akademik me titull "Profesor i Asociuar" ose "Profesor";
- d) dëshmi të gjuhës së huaj, sipas pikës 5.1 (ç);
- dh) dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
- e) vetëdeklarimin e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- ë) projektpropozimi, i hartuar nga kandidati, ku evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
- f) vërtetimin nga qendra e punës, kur kandidati ka eksperiencë pune akademike në fushën përkatëse pranë një institucioni të arsimit të lartë apo ka eksperiencë pune si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar në fushën përkatëse;
- g) mandatpagesën për tarifën e aplikimit;
- gj) vetëdeklarimin e aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- h) dy fotografi.

16.3. Udhëheqësi shkencor për studentin aplikant në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Numri i doktorantëve që mund të udhëheqë personeli akademik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është angazhuar, duhet të jetë jo më i lartë se numri i përcaktuar nga aktet nënligjore në fuqi.

16.4. Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga një komision *ad hoc* me jo më pak se 3 (tre) anëtarë, në përbërjen e të cilit janë të gjithë anëtarë të njësisë bazë të kategorisë "Profesor". Në rast kur ky numër nuk arrihet, atëherë në komision marrin pjesë anëtarë të njësisë kryesore ku organizohet programi i studimit të Doktoratës, të kategorisë "Profesor". Komisioni përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve. Çdo vendimmarrje e këtij komisioni *ad hoc* lidhur me vlerësimin dhe përzgjedhjen bëhet transparente dhe publikohet në faqen zyrtare web të Universitetit, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

16.5. Komisioni *ad hoc*, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve themelore, bën përzgjedhjen e kandidatëve mbështetur në propozimin e aplikantit dhe të dokumentacionit në dosjen përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kriterëve specifike të aplikantëve. Lista e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni *ad hoc*, miratohet në mbledhjen e njësisë bazë.

16.6. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda 3 (tri) ditëve punë nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë sekretarisë së njësies kryesore.

16.7. Shqyrtimi i ankesave dhe marrja e vendimeve përkatëse bëhet brenda 2 (dy) ditëve punë mbas mbarimit të afatit të ankesave. Pas kësaj Njësia bazë njofton me shkresë përcjellëse Dekanin për kandidatët fitues.

16.8. Midis kandidatit fitues dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, lidhet një kontratë tip.

Neni 17

Afatet e pranimit në programin e studimit doktoratë

17.1. Çdo njësi bazë duhet të përcaktojë kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues mundësisht në të njëjtën kohë me afatet e parashikuara si për të gjitha programet e studimit, që ofron njësia. Kuotat dhe kriteret i përcillen Senatit Akademik të USH-së për miratim.

17.2. Çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.

17.3. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të IAL-së, si dhe në ambientet e tyre, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.

Neni 18

Plotësimi dhe njohja e krediteve

18. Në rastet kur në aktet e hapjes së doktoratës përcaktohet plotësimi i krediteve:

- a. Studentët e degëve të përafërta dhe studentët që kanë fituar diplomë 4-vjeçare, sipas përcaktimeve të njësies bazë dhe miratimit nga ana e KD-së, janë të detyruar të japin provim lëndë specifike, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me drejtimin përkatës, duke plotësuar edhe numrin e krediteve që u mungojnë.
- b. Doktorantët brenda vitit të parë, janë të detyruar të japin provim të thelluar në fushën në të cilën kanë zgjedhur të kryejnë studimin.
- c. Për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë në një universitet/qendër tjetër, në varësi të përputhshmërisë së tyre me programin e studimit të doktoratës ku ai është regjistruar, bëhet ekuivalentimi i programeve, duke përcaktuar edhe detyrimet përkatëse.
- ç. Për çdo student të tillë përcaktohen veprimtaritë formuese, modulet lëndore dhe kreditet përkatëse, të cilat ai është i detyruar të fitojë në programin e studimit përkatës të doktoratës.
- d. Në të gjitha këto raste KD ngre komisionet e drejtuara nga koordinatori i programit të doktoratës dhe rast pas rasti përcakton detyrimet e studentëve, duke i dërguar për miratim në KD.

Neni 19

Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të doktoratës

- 19.1.** Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet që parashikohen në aktet në fuqi.
- 19.2.** Njësia bazë duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës në të paktën 3 (tre) raportime, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që ai/ajo bën dhe vlerësimeve me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar.
- 19.3.** Të përfundojë disertacionin në përputhje me kriteret dhe brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore.

Kreu V Diplomimi

Neni 20 Procedura e diplomimit

- 20.1.** Kandidati e dorëzon disertacionin e përfunduar së bashku me dosjen përkatëse pranë koordinаторit të doktoratës, i cili ia përcjell për vlerësim KD-së.
- 20.2.** Dosja e doktoratës përmban:
- a. kërkesën vetjake për mbrojtjen e disertacionit drejtuar KD-së;
 - b. miratimin e paraqitjes për mbrojtje nga ana e udhëheqësit shkencor;
 - c. vendimin e KD-së për miratimin e temës dhe të udhëheqësit shkencor;
 - ç. vendimin e njësisë bazë për paraqitjen e punimit (ku theksohet se doktoranti ka kryer tri diskutime pjesore të punimit të tij pranë njësisë bazë);
 - d. CV;
 - dh. fotokopjen e noterizuar të:
 - diplomës së shkollës së lartë (Bachelor ose diplomë e sistemit 4-vjeçar) dhe të listës së notave;
 - diplomës së “*Masterit të shkencave*” dhe të listës së notave (nëse e ka);
 - e. fotokopjen e noterizuar të certifikatës së mbrojtjes së gjuhës së huaj në një institucion ndërkombëtar të njohur me ligj, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin;
 - ë. kriteret ligjore të plotësuara (formular i firmosur nga doktoranti);
 - f. listën e plotë të botimeve të firmosur nga doktoranti;
 - g. autoreferatin e disertacionit (jo më shumë se 25 faqe) në aq kopje sa janë anëtarë në KD;
 - gj. vendimin e KD-së për ngritjen dhe përbërjen e jurisë (dy pedagogë të jashtëm dhe tre të brendshëm, nga të cilët: 1 kryetar (i brendshëm), 2 oponentë (nga të cilët një i jashtëm) dhe 2 anëtarë);
 - h. vendimin e KD-së për datën e mbrojtjes;
 - i. një kopje e disertacionit (lidhje e thjeshtë) për paraqitje në komisionin e ad-hoc të KD-së;
 - j. pesë kopje të disertacionit (që do t’i dorëzohen jurisë një muaj përpara mbrojtjes);
 - k. disertacionin në formë elektronike (në disk);
 - l. deklaratën me shkrim të studentit që studimi është në përputhje të plotë me kërkesat e Etikës në kërkimin shkencor;
 - ll. vërtetimin për kontrollin e antiplagjiaturës, në masën jo më shumë se 15%.
- 20.3.** Disertacioni është i detyrueshëm në formë elektronike të bëhet publik në faqen e internetit

të USh-së një muaj para mbrojtjes përfundimtare të disertacionit para jurisë përkatëse.

20.4. Koordinatori brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit ia kalon për miratim KD-së dosjen e plotë. Ky i fundit cakton një anëtar të saj, që të relatojë me shkrim për plotësimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të paraqitur nga doktoranti. Nëse KD e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

20.5. KD cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.

Neni 21

Rregullat për paraqitjen e disertacionit

21.1. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij, (2000-2500 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit, disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.

21.2. Disertacioni lidhet në pesë kopje origjinale.

21.3. Njësitë bazë përcaktojnë në rregulloret e tyre specifikimet teknike për punimin, si: kriteret për formatin, gjatësinë e punimit, llojin e letrës, hapësirën midis rreshtave, llojin e shkrimit, margjinat, emërtimin, shënimet, tabelat, diagramet, materialet shoqëruese, citimet dhe referencat, si dhe çdo element tjetër të lidhur me formatimin.

Neni 22

Etika e punës kërkimore

22.1. Çdo disertacion duhet të reflektojë rregullat, që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor.

22.2. Kur dorëzon disertacionin, kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.

22.3. Kandidati nuk lejohet të paraqesë të njëjtin punim, që e ka paraqitur më parë në të njëjtën njësi ose në një njësi tjetër për marrjen e një grade tjetër. Punimi i doktoratës mund të përfshijë pjesë të studimeve të mëparshme, nëse ai tregon qartë në disertacion se cila pjesë e punës është përdorur më parë. Rregulloret e njësive bazë përcaktojnë masën, që lejohet të përfshihet nga punimet e mëparshme në disertacionin e doktoratës.

22.4. Kandidati mund të përfshijë në disertacion edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë ose të dhëna të përfituara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njih kontributin e bashkëpunëtorëve.

22.5. Gjatë periudhës së përgatitjes së disertacionit, kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor në formën e artikujve apo të referimeve shkencore.

22.6. Punimi nuk duhet të përmbajë elemente, që përbëjnë plagjiaturë. Në çdo rast që përdoren ide, fjalë apo koncepte nga burime të tjera duhet të shënohet referenca përkatëse.

22.7. Nëse burimi origjinal nuk gjendet, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të citohen të dy dokumentet, burimi origjinal dhe burimi dytësor.

22.8. Udhëheqësi duhet të sqarojë kandidatin, që në fillim të punës, për rrezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimit dhe plagjiaturës.

22.9. Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për çdo material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës së autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit.

22.10. Në rregulloret e hartuara nga njësitë bazë për organizimin dhe funksionimin e programit të tyre të studimit të doktoratës, gjejnë rregullim kontrolli i plagjiaturës si edhe niveli i pranuar i saj, i cili duhet të jetë jo më i lartë se përqindja e miratuar nga aktet nënligjore në fuqi.

Neni 23

Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës

23.1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin personelit akademik të njërive bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja.

23.2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë rregullore, si dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë e plotësimit të kriterëve formale dhe kontrollit antiplagjiaturë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

23.3. Komisioni miraton jurinë dhe datën e mbrojtjes së disertacionit, sipas propozimit të njësisë bazë. Anëtarët e jurisë duhet t’i përkasin Kategorisë “Profesor”. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit dhe njëri prej tyre është anëtar i jashtëm. Kryetar i jurisë caktohet një nga anëtarët e brendshëm.

23.4. Kur, për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, koordinatori vë në dijeni kryetarin e KD-së, duke i propozuar një datë tjetër për mbrojtjen. Këshilli i doktoratës bën miratimin. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.

23.5. Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

23.6. Komisioni, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi Dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 24

Mbrojtja e doktoratës

24.1. Mbrojtja e doktoratës bëhet e hapur.

24.2. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë.

24.3. Procedura e mbrojtjes së disertacionit përfshin:

- paraqitjen nga kryetari i jurisë të dokumentacionit të dosjes, përbërjes së jurisë dhe deklarimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
- paraqitjen e disertacionit nga studenti për një kohë prej 25-30 minutash;
- paraqitjen e oponentëve. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të disertacionit, ku saktësohet nëse punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke iu kushtuar vëmendje vlerave origjinale, që paraqet punimi, si dhe duke vënë në dukje anët pozitive e negative të tij (nëse ka të tilla);
- pyetje nga të pranishmit rreth disertacionit dhe oponentëve, drejtuar studentit doktorant;
- diskutime;
- sqarime eventuale nga studenti doktorant dhe udhëheqësi shkencor;
- shpërndarjen e fletëvotimeve të hapura e të paplotësuara dhe votim i fshehtë për vlerësimin e doktoratës;
- pasqyrimin në procesverbal të rezultatit të votimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.

24.4. Punimi vlerësohet me pikë, nga 0-100 pikë, 100-80% e pikëve të mundshme = "shumë mirë", 79-65% e pikëve të mundshme = "mirë", 64-50% e pikëve të mundshme = "mjaftueshëm", 49% e më pak e pikëve të mundshme = "pakalueshëm".

24.5. Doktoranti ka detyrim të dorëzojë një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën e Universitetit dhe një kopje në njësinë bazë, përkundrejt pajisjes me vërtetim për depozitimin e tyre. Në të kundërt, doktoranti nuk pajiset me diplomën përkatëse.

24.6. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor", e cila nënshkruhet nga drejtuesi i njësive kryesore dhe Rektori.

24.7. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë të doktoratës, i përcillet Universitetit të Shkodrës dhe prej andej Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së.

24.8. Nëse jepet vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj. Në këtë rast, studenti duhet të lajmërohet me shkrim nga Dekani mbi vendimin e marrë.

24.9. Kandidati që nuk e fiton mbrojtjen e tezës për herë të dytë, rrëzohet përfundimisht.

Neni 25

Anulimi i gradës shkencore "Doktor"

25.1. Nëse pas mbrojtjes së disertacionit ka të dhëna të besueshme, konstatohet dhe/ose vërtetohet se grada shkencore "Doktor" është fituar në shkelje të rregullave të etikës mbi kërkimin shkencor, ose kur mbrojtja është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor, fillon procedura për anulimin e kësaj grade. Rregulloret e njësive bazë për organizimin dhe

funksionimin e programit të studimit të doktoratës përcaktojnë më tej procedurat, që do të ndiqen për anulimin e gradës shkencore “Doktor”.

25.2. Personi, për të cilin fillon procesi i shqyrtimit të gradës shkencore “Doktor”, duhet të njoftohet në lidhje me shkakun, procedurat që do të ndiqen dhe mbi të drejtën që ka për t’u mbrojtur, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Kreu VI Studentët

Neni 26 Të drejtat dhe detyrimet e studentit të doktoratës

26.1. Studenti ka të drejtë:

- a) të kërkojë të pajiset me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore, që janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”;
- b) të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;
- c) të shfrytëzojë bibliotekën e njësive kryesore apo të njësive të tjera të USH-së, në varësi të specifikave përkatëse të kërkimit;
- ç) të shfrytëzojë bibliotekat e njësive të institucioneve, me të cilat Universiteti i Shkodrës ose njësia kryesore ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademike apo/dhe shkencore, duke paraqitur pranë këtyre institucioneve, dokumentin e lëshuar nga njësia kryesore, mbi qëllimin e studimit të kërkimit dhe statusin e tij si student i ciklit të tretë;
- d) të shfrytëzojë ambientet studimore/kërkimore dhe bazën e të dhënave pranë institucioneve publike/private që do të mund t’i nevojiten atij për kërkimin shkencor, mbi bazën e rekomandimeve që njësia kryesore do të lëshojë rast pas rasti;
- dh) të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës, duke paraqitur kërkesën me shkrim pranë njësive bazë.

26.2. Studenti ka për detyrë:

- a) të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë dhe këtë rregullore;
- b) të respektojë dhe zbatojë programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
- c) të respektojë afatet e parashikuara për realizimin e studimeve të doktoratës dhe shlyerjen e detyrimeve financiare (për studentët që janë me vetëfinancim);
- ç) të raportojë, të paktën 3 (tre) herë gjatë gjithë ciklit të studimit, në njësine bazë të programit mbi ecurinë e punës për realizimin e programit të kërkimit dhe veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore;
- d) të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën në këtë rregullore dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;
- dh) të respektojë etikën dhe integritetin në kërkimin shkencor gjatë hartimit të disertacionit;
- e) të dorëzojë brenda afateve ligjore disertacionin dhe dosjen përkatëse, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

26.3. Lëvizja e studentëve.

Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe të projekteve kombëtare e ndërkombëtare, në të cilat merr pjesë programi i doktoratës. Ata mund ta kryejnë aktivitetin e tyre kërkimor në institucione vendase apo të huaja.

Kreu VII Financimi

Neni 27 Burimi i financimit

- 27.1. Doktorata mbahet me vetëfinancim. Të ardhurat e saj formohen nga tarifa e shkollimit e paguar nga studentët, tarifa e regjistrimit për konkurrim dhe nga të ardhurat e tjera të ligjshme.
- 27.2. Doktorata ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 28 Tarifa e shkollimit dhe tarifa e regjistrimit

- 28.1. Tarifa e shkollimit për programet e doktoratës përcaktohet në bazë të ligjeve në fuqi.
- 28.2. Studenti është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës së shkollimit në datën e caktuar. Studenti i cili nuk kryen pagesën e tarifës së shkollimit në afatin e caktuar, i hiqet përkohësisht e drejta për të vazhduar studimet.
- 28.3. Tarifa e regjistrimit për konkursin e pranimit. Secili kandidat që dëshiron të regjistrohet për konkursin e pranimit në programet e doktoratës duhet të paguajë në ditën e regjistrimit për konkurs një tarifë të caktuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi apo vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të USH-së. Kjo tarifë regjistrimi është e pakthyeshme për kandidatët e regjistruar në konkursin e pranimit. Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit në konkursin e pranimit duhet të shoqërojë dokumentin e aplikimit dhe të përfshihet në dosjen e kandidatit.

Kreu VIII Marrëdhëniet me partnerët

Neni 29 Marrëdhëniet me partnerët

- 29.1. Njësia bazë, për realizimin e programit të studimit të doktoratës, mund të vendosë marrëdhënie me bashkëpunëtorë. Si bashkëpunëtorë mund të jenë institucione e organizma publikë dhe privatë, si dhe individë me veprimtari në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.
- 29.2. Bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit të doktoratës me institucionet dhe individët kryhet mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të negociuara nga njësia bazë.

Kreu IX

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit të doktoratës

Neni 30

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit të doktoratës

30.1. Njësia bazë ku realizohet doktorata kryen çdo vit vlerësimin e brendshëm. Ajo kërkon akreditimin e programit të saj të doktoratës në afatet e parashkruara me ligj.

Kreu X

Dispozita të fundit

Neni 31

Dispozita kalimtare

Kjo rregullore zbatohet për studentët që do të regjistrohen në programet e studimit të doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj. Për studentët që kanë filluar programin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”* dhe të akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

Neni 32

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin GJERAJ

